

VENDIM
Nr.520, datë 25.7.2007

**PËR SHPËRBLIMIN DHE TRAJTIMIN USHQIMOR TË PUNONJËSVE TË AGJENCISË
QENDRORE TË VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE, QË REALIZUAN
PROCESIN E MATURËS SHTETËRORE, 2007**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin, deri në 2 (dy) paga mujore, të 13 (trembëdhjetë) punonjësve, të angazhuar për realizimin e maturës shtetërore, 2007, në periudhat e KOEPS-eve (Koha e ekspozimit potencial të sekretit), në varësi të kontributit të secilit punonjës në këtë proces.

2. Trajtimin me kuotë ushqimore, në shumën 2 000 (dy mijë) lekë në ditë, për të gjithë punonjësit e angazhuar në realizimin e maturës shtetërore, 2007, përfshirë dhe përzgjedhësit e testeve përfundimtare, në të gjithë periudhën e KOEPS-eve.

3. Periudhat e KOEPS-eve për realizimin e maturës shtetërore, 2007, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Agjencisë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, miratuar për vitin 2007.

5. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe Provimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha